

Zelihe SHALA

**PLANET ÇETNIKE PËR SHFAROSJEN E POPULLATËS
MYSLIMANE DHE SHQIPTARE**

Lufta e Dytë Botërore solli shumë ndryshime dhe zhvillime të bujshme në territorin e ish-Jugosllavisë. Kjo situatë nxori në pah forcat antifashiste që luftonin për t'u çliruar nga nazizmi dhe fashizmi. Në këtë vorbull ngjarjesh dhe zhvillimesh, nxorën kokë elementët nacionalistë të cilët përfituan më së shumti. Në radhë të parë ishin çetnikët serbë të cilët konsideroheshin si mbështetës të ish-mbretit të tyre Petrit të Dytë. Ata krijuan *Shtabin e Komandës së radhëve Çetnike të Ushtrisë jugosllave*. Ky grup nacionalistësh serbë kishin për qëllim krijimin e një Serbie të gjerë në dëm të territoreve të fqinjëve por edhe mendonin ta zbatonin programin e Vasa Çubrilloviqit, i njohur si një shovinist i madh serb. Kësaj radhe viktimë ishte elementi nacional shqiptar si dhe ai mysliman. Nga të dyja anët ishin shqiptarët që do të viktimizoheshin. Siç do të shihet më vonë pikërisht shqiptarët do të viheshin *në tehun e shpatës*, vuajtjet e të cilëve nuk do të pushojnë as pas përfundimit të LDB, kur e themi këtë kemi parasysh faktin se shqiptarët ndiqeshin vetëm e vetëm se ishin shqiptarë por edhe si element mysliman. Pra, në kurrizin e tyre ngarkoheshin dy elementë të padëshirueshëm. Ideja për zhbërjen e elementit do të vazhdojnë deri në vitet e '60-ta deri kur dominoi pushteti me ambicie serbomëdha i Rankoviqit, pushtet i cili u ripërtëri pas viteve '80-ta.

Dokumentet çetnike mbi aneksimin e trojeve shqiptare

Synimet e çetnikëve serbo - malazezë kishin zgjedhur tokat shqiptare si edhe territoret tjera në ish-Jugosllavi mbi të cilat donin të krijonin Serbinë e Madhe dhe Malin e Zi. Këto qëllime pasqyrohen qartë në dokumentet sekrete të tyre të cilat do t'i hedhim në dritë në këtë shkrim të shkurtër. Në dokumentin me numër 370 të Shtabit të

Komandës së Radhëve Çetnike të Ushtrisë jugosllave, me në krye majorin e Shtabit të Përgjithshëm z. Gjorgje Loshiq nga Mali i Zi dhe udhëheqësi i Komandës së Radhëve Çetnike të Limit të Ushtrisë Jugosllave, Pavle Gjureshiqit¹sidhe dokumenti me nr. 1 154 i Komandës së Ushtrisë Jugosllave të Atdheut, Korpusi Sulmues i Kosovës, i datës 14 nëntor 1944.² Për të arritur qëllimin e tyre serbo - malazezët, shpresat i mbështetnin tek mbreti i cili bashkë me qeverinë³ vepronte në ekzil. Ai ishte i ngarkuar që të vepronte në fushën diplomatike në qarqet ushtarake gjithashtu pranë aleatëve të mëdhenj.⁴ Mirëpo, barra kryesore i binte organizimit të çetave çetnike të cilat do të vepronin në terren, nën moton e krijuar të ushtarëve çetnik *“lufta për popull”, d. m .th. le të ndijojmë se çka dëshiron populli e pastaj atë ta punojë.*⁵ Meqenëse lufta e tyre kishte karakter nacionalist dhe mbështetej në të vetmin qëllimin *“lirinë e popullit”*, ata nuk duhej të kursenin asgjë për realizimin e objektivave të veta⁶, pra duhej të pushtonin sa më shumë toka të popujve jo serb e malazez.

Shtabi i Komandës së Radhëve Çetnike të Ushtrisë Jugosllave synimet e veta i parashtronnë 10 pika kryesore të cilat në pjesën më të madhe drejtpërdrejt rrezikojnë trevat shqiptare e myslimane.⁷ E me qenë se *qëllimi dhe projektimi* i planeve çetnike ishte shfarosja e popullsisë myslimane dhe shqiptare⁸, çetnikët përdornin pretekstet se gjoja Ushtria jugosllave u tradhtua nga elementë të shumtë të errshim e për atë arsye patë mbërri katastrofën e madhe.⁹ Për këtë katastrofë Shtabi i Komandës Çetnike i bënë fajtor të gjithë ushtarët myslimanë që në ditët tragjike pa mëshirshëm e zhduknin popullsinë tonë¹⁰ (popullin serb, Z. Sh). Me paragjykime të tilla dhe pretekste të këtij lloji, çetnikët i kishin vënë objektivë vetës që të bënin spastrime etnike e territoriale të mëdha duke

¹A. Sh. K., Fondi: Dokumente armiqësore viti 1941 - 44, Kutia nr. 41, Nr. dokumentit 946, Shtabi i Komandës së radhëve Çetnike të Ushtrisë Jugosllave, 20 dhjetor 1941.

²A. Sh. K., Fondi: Dokumente Armiqësore viti 1941 - 44, Kutia nr. 41, Nr. dokumentit 1154, Komanda e Ushtrisë Jugosllave të Atdheut Korpusi Sulmues I Kosovës i datës 14.11.1944.

³Po aty.

⁴Po aty.

⁵Po aty.

⁶Po aty

⁷Po aty.

⁸A. Sh. K., Fondi: Dokumente armiqësore viti 1941 - 44, Kutia nr. 41, Nr. dokumentit 946, Shtabi i Komandës së Radhëve Çetnike të Ushtrisë Jugosllave, 20 dhjetor 1941.

⁹Po aty.

¹⁰Po aty.

njekë, vrarë dhe shpërngulur popullsinë myslimane, por edhe shqiptare, ashtu siç kishte vepruar Mbretëria Serbe dhe ajo Malit të Zi në vitin 1912-15. Gjatë këtyre viteve ata patën për qëllim që t'i detyronin shqiptarët me propaganda të rreme dhe më shumë me dhunë të largohen nga viset ku ata ishin banorë shumicë.¹¹ Në saje të këtij aksioni famëkeq vetëm brenda dy vitesh (1912 - 14), në Turqi u shpërngulën 40 000 veta.¹² Me çdo kusht çetnikët dëshironin t'i përmbushnin synimet e tyre të errëta dhe kërkonin t'i rimerrnin territoret, që gjithnjë sipas logjikës së tyre hegjemoniste u takonin atyre dhe se pushtuesi italian, gjerman dhe bullgar ua kishte okupuar. Ku plan hegjemonist i tyre duhet të shtrihej mbi shumicën e territoreve të Shqipërisë së Veriut dhe deri në Shkodër, sepse kinse dëshironin që të siguronin Malin e Zi nga sulmet e elementit shqiptarë nga Shqipëria.¹³ Për çetnikët ishte e domosdoshme që të bëhej spastrimi i territorit shtetëror nga të gjitha pakicat kombëtare jo serbe.¹⁴ Ideja e tyre mbështetej në shtrirjen e kufijve të përbashkët në mes të Serbisë dhe Cërnagorës si dhe kufirit në mes Serbisë dhe Sllovenisë duke spastruar Sanxhakun dhe Bosnjën nga popullsia myslimane dhe kroate.¹⁵ Atëherë, kur do të arrihej të pastroheshin viset e lakmuara në ato vise do të bëhej kolonizimi me elementin malazez (në plan nuk hyjnë vetëm familjet e vobekta të mirësjellshëm e të ndershme).¹⁶

Në këto dokumente që jemi duke i përfolur më tutje ceket se ishte e nevojshme të sigurohej trupi politik i cili do të udhëheq anijen shtetërore drejt dëshirave dhe interesave të mëdha, por për këtë qëllim duhej të shkohej deri edhe te lufta që do të ishte shtetërore për të arritur përmbushjen e dëshirave dhe interesave të popullit¹⁷, e që nënkuptohet të atij serb. Gjithashtu u bëhej thirrje të gjitha elementeve Kombëtare (Nacionale) që të rreshtohen sa më parë në radhët çetnike sepse ngjarjet zhvilloheshin me një shpejtësi të mrekullueshme e s'duhet të na gjen të papërgatitur.¹⁸

¹¹E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë, 1990, f. 259.

¹²*Po aty.*

¹³*Po aty.*

¹⁴*A. Sh. K.*, Nr. dokumentit 946, Shtabi i Komandës së Radhëve Çetnike të Ushtrisë Jugosllave, 20 dhjetor 1941, Fondi: Dokumente Armiqësore viti 1941 - 44, Kutia nr. 41.

¹⁵*Po aty.*

¹⁶*Po aty.*

¹⁷*Po aty.*

¹⁸*Po aty.*

Problem në vete që pengonte realizimin e projekteve çetnike, ishin komunistët dhe partizanët, ngase me ta s'mund të bëhet kurrfarë bashkëpunimi sepse ata luftojnë kundra Dinastisë (Familjes Mbretërore) dhe për realizimin revolucionit shoqëror.¹⁹ Ndërkaq, në një letër që i dërgohet shtabit rus, kërkohet që ata të intervenonin tek njësitet popullore partizane që të mos i sulmonin²⁰ çetat çetnike sepse ata po luftonin kundër armikut të përbashkët gjermanëve dhe arnautëve (shqiptarëve Z.SH.). Kërkohet një intervenim i tillë, nga pala ruse, sepse sa herë që kanë ndërmarrë sulme kundër gjermanëve, prapa shpine janë sulmuar nga partizanët.²¹ Në mes tjerash kjo komandë kërkon që urgjentisht të urdhërohen partizanët për të lidhur një marrëveshje, kur dihet mirëfilli se korpusi i Kosovës numëronte 5 000 njerëz të armatosur të cilët ishin në gjendje të jepnin kontributin e vetë të madh për çlirimin e atdheut²² dhe se qëllimi ynë është i njëjtë kur dihet që ne jemi vetëm ushtarë e luftëtarë për mbretin, atdheun e popullin e lirë.²³

Për të qenë sa më të përgatitur kur të ndërmerren aksionet çetnike kundër tokave shqiptare, myslimane dhe kroate, ata llogarisin për të përdorur të gjitha radhët çetnike në Mal të Zi, në momentin kur mendohet se duhet të vihen në jetë këto qëllime.²⁴ Sulmet do të drejtoheshin në fillim në Luginën e lumit Lim drejt Belles që do të kenë detyrë parësore të spastrojnë Peshterin nga popullata myslimane dhe shqiptare.²⁵ Të gjitha forcat çetnike duhet të bashkëpunonin me radhët e Galisë dhe Javorit.²⁶ Sulmi i dytë do të orientohet në drejtim të Çakorit, Rugovës - Metohisë gjithnjë me qëllim që të spastrohen këto vise nga elementi shqiptar, për të zbatuar në përpikëri synimet duhej të priten e të vriten të gjithë ata që ikin nga Peshteri dhe Sanxhaku. Këto forca duhet të bashkëpunojnë me forcat e radhëve të Kopaonikut²⁷, kurse sulmi i tretë do të bëhet në Primorje dhe Dubrovnik. Të gjitha këto forca duhet të bashkëpunojnë me kolonën e majtë të Dangiçit e cila do të veprojë

¹⁹ *Po aty.*

²⁰ *A.Sh.K.*, Fondi: „Dokumentet armiqësore“, dok. 1154, Br, str. pov. 14, nëntor 1944, Kutia 41.

²¹ *Po aty.*

²² *Po aty.*

²³ *Po aty.*

²⁴ *Po aty.*

²⁵ *Po aty.*

²⁶ *Po aty.*

²⁷ *Po aty.*

(sulmojë) Mostarin.²⁸ Dhe drejtimi i katërt i sulmeve planifikohej të orientohej drejt jugut me qëllimin që të pushtohet Shkodra dhe në këto raste qëllimisht të sigurohet Mali i Zi prej sulmit shqiptar nga Shqipëria.²⁹

Të gjitha çetat çetnike thuhet se ishin të obliguara të mbanin lidhje me Komandën, me anë të korijerëve dhe të bënin përgatitjet e duhura për të kontrolluar aeroportet prej nga do të zbarkonin ndihmat që do të vinin nga jashtë ose të jepeshin koordinatat e sakta se ku duhet të lëshoheshin ato, me parashuta, por kërkoheshin gjithashtu si shumë e nevojshme që vendet duhej të ndriçoheshin³⁰ vazhdimisht. Po ashtu, çetnikët e kishin shumë të nevojshme sigurimin e një rruge për krahina detare për në brendësinë e vendit, sepse është e mundur që ndihmat të vijë përmes detit.³¹ Çetnikët duhet të kishin parasysht që lidhja me Dangiçin, në Bosnje të bëhet përmes Gaçkos dhe Bileqes dhe nëpër Foçë drejt Kolinevikut.³² Kurse lidhja me radhën çetnike serbe kërkoheshin të mbahej me anë të radhëve çetnike të Limit.³³

Përgatitja e çetave çetnike dhe planet e tyre shoviniste shfarosëse ndaj shqiptarëve ishin gjithnjë aktuale dhe të gatshme. I vetmi popull që ishte “halë në sy” si për serbët ashtu edhe për malazezët, ishte populli shqiptar si tërësi autoktone që i prishte planet dhe synimet e tyre hegjemoniste. Prandaj, planet e paraqitura kishin një rëndësi të përhershme dhe konsideroheshin si shumë të rëndësishme për të gjitha projektet hegjemoniste të forcave serbe e malazeze.

²⁸ *Po aty.*

²⁹ *Po aty.*

³⁰ *Po aty.*

³¹ *Po aty.*

³² *Po aty.*

³³ *Po aty.*

Zelihe SHALA

SUMMARY

**THE CHETNIK PLANS FOR THE ELIMINATION OF THE
ALBANIAN AND MUSLIM POPULATION**

Throughout the history Albanians were conquered by foreign forces and subdued to terror and ethnic cleansing from the neighboring countries (Serbia, Montenegro, Greece, etc.) who attempted to actualize their hegemonic plans by conquering Albanian lands. Therefore, it is not by chance that we discuss the documents presented above, which documents introduce the Serbian projects towards the Albanian issue, much similar to those introduced by Garashanin, Cubrilovic, and finally those of Mihajlovic.

The Serbs aimed to acquire access to the Adriatic, and they believed that this would be achieved only through eliminating the Albanian population which to them represented the greatest obstacle. Aside from gaining access to the sea, the Serbs were fundamentally aiming to rid of the Albanian element in the area. The Montenegrins on the other hand aimed to assess their dominance over the fertile Albanian lands. To achieve these goals, the Albanian element needed to be eliminated. The Chetniks were the most active in this direction during the Second World War, having had targeted the Albanians and Muslims. These documents in Serbian are only a small portion of the numerous documents that introduce to us the hegemonic Serbian plans.